



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Kodi i lëndës: INF 230

Lënda: Farmakologji

PROGRAMI I LËNDËS									
Farmakologji									
Titullari i lëndës:		Majlinda Zahaj <i>PhD në Shkenca Paraklinike</i>							
Ngarkesa:	Kredite	Orë mësimi në auditor						Studim individual	Totali
		Leksion	Seminar	Ushtr	Praktikë	Projekt	Total		
	8 ECTS	45	4	24	0	2	75	125	200
Tipologjia e lëndës		Disiplinë e formimit karakterizues të programit							
Viti akademik /Semestri kur zhvillohet lënda		Viti II, Semestri I							
Lloji i lëndës		E detyruar							
Programi i studimit		Bachelor në "Infermieri të Përgjithshme"							
Kodi i lëndës		INF 230							
Adresa elektronik e titullarit / pedagogut të lëndës		majlinda.zahaj@univlora.edu.al							

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT	
Përshkrimi i lëndës	Ky modul ofron njohuritë bazë për medikamentet. Ndahet në 2 pjesë: 1-Farmakologjia e përgjithshme ku studiohet dozimi i barnave, farmakokinetika, farmakodinamika, efektet e padëshiruara dhe rregullat e përdorimit të barnave në përgjithësi, dhe 2- Farmakologjia speciale ku për çdo grup medikamentesh sipas klasifikimit të OBSH, studiohen: përfaqësuesit, farmakokinetika, efektet farmakologjike, indikacionet, kundërindikacionet, efektet e padëshiruara dhe kujdesi infermior.
Objektivat e lëndës	<ul style="list-style-type: none">☞ Përfitimi i njohurive bazë mbi mënyrat e studimit, prodhimit dhe përdorimit të barnave☞ Përfitimi i njohurive specifike për çdo grup barnash sipas klasifikimit të OBSH.☞ Aftësimi i studentëve për kujdesin infermior gjatë aplikimit të terapive të ndryshme
Rezultatet e pritshme	Në përfundim të kursit studentët do të jenë në gjendje: <ul style="list-style-type: none">▪ Të njohin grupet kryesore të barnave me përfaqësuesit kryesorë për secilin grup▪ Të njohin efektet farmakologjike, indikacionet dhe kundërindikacionet për secilin grup▪ Të vlerësojnë dhe parandalojnë efektet e padëshiruara të barnave nëpërmjet kujdesit përkatës infermior.

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"**
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË**KONCEPTET THEMELORE**

1. Farmakologjia është shkencë që merret me studimin e barnave. Ndahet në farmakologjinë e përgjithshme dhe farmakologjinë speciale.
2. Farmakologjia e përgjithshme studion mënyrat e prodhimit të barnave, format farmaceutike, dozimin, farmakokinetikën, farmakodinamikën, efektet e padëshruara dhe kujdesjet në përgjithësi në përdorimin e barnave.
3. Farmakologjia speciale studion për çdo grup barnash sipas klasifikimit të OBSH, përfaqësuesit kryesorë, farmakokinetikën e grupit, veprimet farmakologjike, indikacionet, kundërindikacionet dhe efektet e padëshruara.
4. Për secilin prej grupeve, një vend të rëndësishëm ka kujdesi infermior gjatë dhe mbas aplikimit të barnave.

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
I.	Tema 1 – Njohja me programin dhe kërkesat e lëndës. Hyrje në farmakologji. <i>Organizimi dhe fokusi i studimit të lëndës. Njohja me literaturën bazë dhe teknikat që do trajtohen në modul.</i>	<i>fq.3-12</i>	Leksion 1 orë
	Tema 2 – Format farmaceutike të barnave. <i>Ndarja e barnave sipas formës fizike në të ngurta, të lëngëta dhe të buta.</i>	<i>fq.12-16</i>	Leksion 1 orë
	Tema 3 – Dozimi i medikamenteve. <i>Njohja me mënyrat e llogaritjes së barnave në formë të ndryshme, për t'i dhënë pacientit dozën e rekomanduar nga mjeku, me shpejtësinë dhe mënyrën e duhur.</i>	<i>fq.16-21</i>	Leksion 1 orë
	Ushtrime 1/2 – Ushtrime mbi format farmaceutike të barnave.		<i>Ushtrime 2 orë</i>
II.	Tema 4 – Rrugët e marrjes së barnave. <i>Njohja me rrugët natyrore dhe artificiale të administrimit të medikamenteve. Vecoritë dhe mënyra e kryerjes për secilën.</i>	<i>fq.22-35</i>	Leksion 1 orë
	Tema 5 - Shpërndarja, metabolizmi dhe ekskretimi i barnave. <i>Njohja me mënyrat e shpërndarjes së barnave nëpërmjet gjakut, vendet kryesore të metabolizmit të tyre dhe rrugët kryesore të ekskretimit.</i>	<i>fq.35-39</i>	Leksion 1 orë
	Tema 6 –Faktorët që ndikojnë në efektin e barit. <i>Njohja me faktorët e lidhur me barin, faktorët e lidhur me organizmin dhe faktorët e jashtëm që ndikojnë në shfaqjen e efektit farmakologjik të barnave.</i>	<i>fq.40-45</i>	Leksion 1 orë
	Ushtrime 3/4 –Leximi i recetës ose kartelës mjekësore dhe mënyra e llogaritjes së formave farmaceutike të ngurta.		<i>Ushtrime 2 orë</i>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

III.	Tema 7 – Efektet e padëshiruara të barnave. <i>Njohja me efektet toksike, reaksionet alergjike, idiosinkrazinë, ambjentimin, vartësinë, takifilaksinë, akumulimin dhe efektet lokale të barnave.</i>	<i>fq.46-48</i>	Leksion 1 orë
	Tema 8 – Kujdesi në përdorimin e barnave. <i>Përgatitja e barnave për përdorim dhe detyrat e infermierit gjatë përdorimit të barnave.</i>	<i>fq.49-52</i>	Leksion 1 orë
	Tema 9 – Instruktimi i pacientit dhe familjarëve gjatë përdorimit të barnave. <i>Një nga detyrat e infermierit është instruktimi i pacientit dhe familjarëve të tij për medikamentet.</i>	<i>fq.53-55</i>	Leksion 1 orë
	Ushtrime 5 -Mënyra e llogaritjes së sasisë së tretësirës që do marrë pacienti nga goja. Ushtrime 6 - Mënyra e llogaritjes së sasisë së tretësirës që do t'i injektohet pacientit.		<i>Ushtrime 2 orë</i>
IV.	Tema 10 – Adrenomimetikët <i>Klasifikimi, farmakokinetika, farmakodinamika dhe kujdesi infermior për adrenomimetikët.</i>	<i>fq.61-66</i>	Leksion 1 orë
	Tema 11 – Adrenoblokuesit <i>Klasifikimi, farmakokinetika, farmakodinamika dhe kujdesi infermior për adrenoblokuesit.</i>	<i>fq.67-73</i>	Leksion 1 orë
	Tema 12 - Kolinomimetikët <i>Klasifikimi, farmakokinetika, farmakodinamika dhe kujdesi infermior për kolinomimetiket.</i>	<i>fq.74-79</i>	Leksion 1 orë
	Ushtrime 7 - Mënyra e llogaritjes të shpejtësisë së dhënies së tretësirave në rrugën I/V. Seminar 1 - Farmakokinetika dhe farmakodinamika.		<i>Ushtrime 1 orë</i> <i>Seminar 1 orë</i>
V.	Tema 13 – Kolinoblokuesit <i>Klasifikimi, farmakokinetika, farmakodinamika dhe kujdesi infermior për kolinoblokuesit.</i>	<i>fq.80-87</i>	Leksion 1 orë
	Tema 14 –Analgjektivët morfinkë <i>Klasifikimi, farmakokinetika, farmakodinamika dhe kujdesi infermior për analgjektivët morfinkë.</i>	<i>fq.88-96</i>	Leksion 1 orë
	Tema 15 – Antiinflamatorët jo steroidë <i>Klasifikimi, farmakokinetika, farmakodinamika dhe kujdesi infermior për antiinflamatorët jo steroidë.</i>	<i>fq 97-106</i>	Leksion 1 orë
	Ushtrime 8/9 - Ushtrime mbi barnat që veprojnë në SNV		<i>Ushtrime 2 orë</i>
VI.	Tema 16 – Barnat anestezike <i>Njohja me llojet e anestezisë, anestetikët lokalë dhe anestetikët e përgjithshëm.</i>	<i>fq.107-115</i>	Leksion 1 orë
	Tema 17 – Sedativët dhe hipnotikët <i>Klasifikimi, farmakokinetika, farmakodinamika dhe kujdesi infermior për sedativo-hipnotikët.</i>	<i>fq.116-123</i>	Leksion 1 orë
	Tema 18 - Antikonvulsivët <i>Klasifikimi, farmakokinetika, farmakodinamika dhe kujdesi infermior për antikonvulsivët.</i>	<i>fq. 1124-129</i>	Leksion 1 orë
	Ushtrime 10/11 - Ushtrime mbi barnat kundër dhimbjes		<i>Ushtrime 2 orë</i>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

VII.	Tema 19 – Antiparkinsonikët <i>Klasifikimi, farmakokinetika, farmakodinamika dhe kujdesi infermieror për antiparkinsonikët.</i>	<i>fq.1130-134</i>	Leksion 1 orë
	Tema 20 – Antidepresivët <i>Klasifikimi, farmakokinetika, farmakodinamika dhe kujdesi infermieror për antidepresivët.</i>	<i>fq.135-139</i>	Leksion 1 orë
	Tema 21 – Antipsikotikët <i>Klasifikimi, farmakokinetika, farmakodinamika dhe kujdesi infermieror për antipsikotikët.</i>	<i>fq.140-146</i>	Leksion 1 orë
	Ushtrime 12/13- Ushtrime mbi barnat që veprojnë në SNQ		<i>Ushtrime 2 orë</i>
VIII.	Tema 22 – Stimuluesit e SNQ <i>Klasifikimi, farmakokinetika, farmakodinamika dhe kujdesi infermieror për stimuluesit e SNQ.</i>	<i>fq.147-151</i>	Leksion 1 orë
	Tema 23 –Kardiotonikët <i>Klasifikimi, farmakokinetika, farmakodinamika dhe kujdesi infermieror për kardiotonikët.</i>	<i>fq.152-157</i>	Leksion 1 orë
	Tema 24 –Antiaritmikët <i>Klasifikimi, farmakokinetika, farmakodinamika dhe kujdesi infermieror për antiaritmikët.</i>	<i>fq.158-162</i>	Leksion 1 orë
	Seminar 2- Diskutim mbi barnat që veprojnë në Sistemin Nervor Ushtrime 14- Ushtrime mbi kardiotonikët dhe antiaritmikët.		<i>Seminar 1 ore</i> <i>Ushtrime 1 orë</i>
IX.	Tema 25 – Antianginozët <i>Klasifikimi, farmakokinetika, farmakodinamika dhe kujdesi infermieror për antianginozët.</i>	<i>fq.163-172</i>	Leksion 1 orë
	Tema 26 – Diuretikët <i>Klasifikimi, farmakokinetika, farmakodinamika dhe kujdesi infermieror për diuretikët.</i>	<i>fq.173-181</i>	Leksion 1 orë
	Tema 27 –Antihipertensivët <i>Klasifikimi, farmakokinetika, farmakodinamika dhe kujdesi infermieror për antihipertensivët.</i>	<i>fq.182-194</i>	Leksion 1 orë
	Ushtrime 15/16- Ushtrime mbi antianginozët, diuretikët, antihipertensivët.		<i>Ushtrime 2 orë</i>
X.	Tema 28 – Hipolipemiantët <i>Klasifikimi, farmakokinetika, farmakodinamika dhe kujdesi infermieror për hipolipemiantët.</i>	<i>fq.195-199</i>	Leksion 1 orë
	Tema 29 – Koagulantët dhe antikoagulantët <i>Klasifikimi, farmakokinetika, farmakodinamika dhe kujdesi infermieror për koagulantët dhe antikoagulantët.</i>	<i>fq.200-216</i>	Leksion 1 orë
	Tema 30- Antianemikët <i>Klasifikimi, farmakokinetika, farmakodinamika dhe kujdesi infermieror për antianemikët.</i>	<i>fq.217-223</i>	Leksion 1 orë
	Ushtrime 17/18- Ushtrime mbi barnat që veprojnë në indin e gjakut.		<i>Ushtrime 2 orë</i>
XI.	Tema 31 – Elektrolitët dhe zëvendësuesit e plazmës <i>Njohja me tretësit që përdoren për ekuilibrin e lëngjeve në organizëm, si dhe me elektrolitët. Shenjat e crregullimeve elektrolitike dhe kujdesi infermieror.</i>	<i>fq.224-233</i>	Leksion 1 orë
	Tema 32 –Vitaminat	<i>fq.234-243</i>	Leksion 1 orë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

	<p>Njohja me vitaminat hidrosolubile dhe liposolubile, burimet kryesore të tyre, shenjat e deficitit të tyre në organizëm dhe përdorimet. Tema 33- Farmakologjia e aparatit respirator <i>Klasifikimi, farmakokinetika, farmakodinamika dhe kujdesi infermieror për grupet e barnave që veprojnë në sistemin respirator.</i></p> <p>Seminar 3 - Diskutim mbi barnat që veprojnë në Sistemin Kardio-vaskular dhe në indin e gjakut. Ushtrime 19- Ushtrime mbi elektrolitët dhe vitaminat</p>	<p><i>fq.244-256</i></p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Seminar 1 orë</p> <p>Ushtrime 1 orë</p>
XII.	<p>Tema 34 – Farmakologjia e aparatit tretës <i>Klasifikimi, farmakokinetika, farmakodinamika dhe kujdesi infermieror për grupet e barnave që veprojnë në sistemin tretës.</i></p> <p>Tema 35 – 36 - Antibakterialët <i>Njohja me gjithë grupet e antibiotikëve, klasifikimi, spektri i veprimit, përdorimet, efektet e padëshiruara dhe kujdesi infermieror.</i></p> <p>Ushtrime 20 - 21- Ushtrime mbi barnat që veprojnë në aparatit respirator dhe aparatit tretës.</p>	<p><i>fq.257-270</i></p> <p><i>fq.272-312</i></p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 2 orë</p> <p>Ushtrime 2 orë</p>
XIII.	<p>Tema 37- Antimykotikët dhe antiviralët <i>Klasifikimi, farmakokinetika, farmakodinamika dhe kujdesi infermieror për antimykotikët dhe antiviralët.</i></p> <p>Tema 38- Antiparazitarët <i>Klasifikimi, farmakokinetika, farmakodinamika dhe kujdesi infermieror për antiparazitarët.</i></p> <p>Tema 39-Antikancerozët <i>Klasifikimi, farmakokinetika, farmakodinamika dhe kujdesi infermieror për antikancerozët.</i></p> <p>Ushtrime 22/23- Ushtrime mbi kimioterapeutikët.</p>	<p><i>fq.313-320</i></p> <p><i>fq. 321-326</i></p> <p><i>fq. 327-335</i></p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Ushtrime 2 orë</p>
XIV.	<p>Tema 40 - Farmakologjia e hipofizës <i>Njohja me preparatet hormonale të adeno dhe neurohipofizës, përdorimet, efektet e padëshiruara dh kujdesi infermieror.</i></p> <p>Tema 42- Tiroidja dhe barnat antitiroidiene <i>Njohja me preparatet hormonale të gjendrës tiroide dhe antitiroidienët, përdorimet, efektet e padëshiruara dh kujdesi infermieror.</i></p> <p>Tema 43-Insulina dhe hipoglicemiantët orale <i>Klasifikimi, farmakokinetika, farmakodinamika dhe kujdesi infermieror për antidiabetikët.</i></p> <p>Projekte –Paraqitje e detyrave të kursit mbi barnat</p>	<p><i>fq.331-335</i></p> <p><i>fq. 336-341</i></p> <p><i>fq.342-350</i></p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Projekte 2 orë</p>
XV.	<p>Tema 43 – Glukokortikoidet dhe mineralokortikoidet <i>Njohja me preparatet hormonale të korteksit suprarenal, përdorimet, efektet e padëshiruara dh kujdesi infermieror.</i></p> <p>Tema 44 – Farmakologjia e hormoneve seksuale <i>Njohja me preparatet hormonale të gjendrave seksuale, përdorimet, efektet e padëshiruara dhe kujdesi infermieror.</i></p> <p>Tema 45 – Substancat që veprojnë në uterus <i>Njohja me preparatet që veprojnë në uterus, përdorimet, efektet e padëshiruara dh kujdesi infermieror.</i></p> <p>Ushtrime 24- Ushtrime mbi barnat që veprojnë në sistemin endokrin. Seminar 4- Diskutim mbi gjithë materialin e marrë gjatë lëndës.</p>	<p><i>fq.351-356</i></p> <p><i>fq.357-366</i></p> <p><i>fq.367-373</i></p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1orë</p> <p>Ushtrime 1 orë</p> <p>Seminar 1 orë</p>



REPUBLICA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

FORMA E KONTROLLIT TË DIJEVE

FREKUENTIMI:	<p>Kyçi i një edukimi të suksesshëm është pjesëmarrja dhe përgatitja. Kërkohej një pjesëmarrje aktive në klasë. Orët e leksionit janë të detyrueshme në masën 75%. Orët e praktikës janë të detyrueshme 100%, në rast të mungesave të justifikuara ora do të zëvendësohet në marrveshje me pedagogun. Të gjithë studentët duhet të paraqiten në orët e praktikës në orarin e përcaktuar dhe të pajisur me përparëse të bardhë dhe flokë të mbledhur (duke respektuar kodin etik të veshjes së infermierit).</p> <p>Lejohen të shlyhen mungesat deri në masën 25% të orëve, nëse ato janë të justifikuara. Në të kundërt studentit humbet të drejtën e futjes në provim. Mungesat janë përgjegjësi personale e studentit, ashtu sikurse edhe detyrat apo testimet e humbura.</p>						
KONTROLLI I VAZHDUESHËM	<i>Forma e vlerësimit</i>	<i>Koha e vlerësimit</i>	<i>Temat mësimore që do vlerësohen</i>	<i>Pikët maksimale</i>	<i>Forma e testimit të njohurive</i>	<i>Përmbajtja e testimit</i>	
	Provimi i pjesshem	Java7-8	1-15	30 pike	Provimi me shkrim	pyetje me shtjellim dhe pyetje quiz	
	Provimi final	Fundi i semestrit	Gjithë lënda	60 pikë	Provimi me shkrim	pyetje me shtjellim dhe pyetje quiz	
	Vlerësim i vazhduar* (Detyra e kursit*)	Java 14/15	Diskutim ne seminare dhe ushtrime Temë studimore	10 pikë	Prezantim me gojë	Ushtrime Raportimi i studimit shkencor	
	*Detyra e kursit - Do të jetë në formën e një teme studimor mbi barnat dhe përdorimin e tyre. Gjithashtu do meret në konsideratë dhe vlerësimi i studentit gjatë orëve të seminarit prej pedagogut të seminarit.						
	Konvertimi i pikëve në notën përfundimtare do të jetë si më poshtë:						
	40- 49 pikë	50-59 pikë	60-69 pikë	70-79 pikë	80-89 pikë	90-100 pikë	
5	6	7	8	9	10		

LITERATURA

a. Literatura bazë e detyruar	‘Bazat e Farmakologjise Klinike’ Prof./As.Dr. Florika Mandro, Dr. Majlinda Zahaj, etj 2015 (Fakulteti i Mjekësisë - UT) ISBN:99927-35-61-9
b. Literatura e rekomanduar	<p>Marina Vanzetta, Maurizio Volterrani.Farmaci e infermiere.2013.Mondadori. ISBN: 9788838646157</p> <p>Sandro Bartoccioni.Terapia 2015.2015.Mondadori.ISBN: 8890206209</p> <p>Sandro Bartoccioni.Terapia 2016.2016.Mondadori.ISBN: 8890206217</p> <p>Heinz Lüllmann et al. Color Atlas of Pharmacology- Third Edition. 2005. Thieme Stuttgart · New York. ISBN 3-13-781703-X</p> <p>Formulary Committee Joint. British National Formular 68. 2015. Pharmaceutical Press. ISBN-13: 978-0857111388</p>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

VËREJTJE PËRFUNDIMTARE NGA PEDAGOGU I LËNDËS

Dispozita:	Nga studentët pritet që të zhvillojnë vlera dhe një etike që tregon interesat dhe sjelljen e tyre në këndvështrimin profesional. Këto pritshmëri lidhen me paraqitjen në ambientet e Universitetit, përgjegjshmërinë gjatë procesit të mësimdhënies, por jo vetëm, në ndershmërinë e tyre dhe në çështje të drejtësisë sociale. Studentët duhet të respektojnë diferencat individuale, të jenë bashkëpunues, të vlerësojnë aftësitë dhe cilësitë e vetes e të tjerëve, të vlerësojnë format e ndryshme të shprehjes së mendimit dhe zgjedhjeve të secilit. Në përputhje me rregullat etike, studentët duhet të respektojnë diferencat etnike dhe të ndihmojnë me qëndrime integruese e mbështetëse personat me aftësi të kufizuara.
Vonesat	Vonesat në leksione dhe seminare nuk do të tolerohen. Pas hyrjes së pedagogut në auditor nuk lejohet të hyjë asnjë student.
Sjellja profesionale e studentit	Studentët konsiderohen tashmë të rritur dhe kjo kërkon prej tyre një përgjegjësi dhe vet-ndërgjegjësim në një nivel më të lartë në lidhje me sjelljen e tyre, qëllimet e interesat për të cilat ata kanë zgjedhur të frekuentojnë universitetin. Duke patur parasysh që kudo infrastruktura universitare dhe ekologjia e mjedisit ku jepen dijet nuk është e përsosur, duhet të vendosim disa rregulla të detyrueshme për të gjithë. Kjo d.m.th., vëmendje gjatë procesit mëimor, celularë të fikur, jo SMS, jo përdorim të mjeteve të tjera digjitale me destinacion argëtimin (MP3.etj), jo lojra, jo kuti tualeti nëpër tavolinat e mësimit, veshje të përshtatshme për të respektuar orën e mësimit, fjalor (vulgariteti ndalohet rreptësisht) dhe komunikim të pranueshëm brenda dhe jashtë klasës. Për çdo devijancë nga këto rregulla, do të ketë penalitete, që përcaktohen në Rregulloren e Universitetit.
Integriteti akademik dhe e drejta e autorit	Çdo test apo punë me shkrim duhet të jetë tërësisht individuale dhe origjinale. Kjo nënkupton që studentët të krijojnë vetë mbi bazën e koncepteve të argumentuara në leksion abstraksione apo analiza origjinale, dhe në pamundësi të referojnë gjithnjë burimin e informacionit të marrë. Nuk do të lejohen plagjiaturat (përzierjet mikse), apo vjedhjet e informacioneve në rrugë të ndryshme.